



KRIVA PALLANKA – PORTA LINDORE KAH EVROPA (ATRAKSION FESTIVALO - TURISTIK)

Plani për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet sociale

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT	3
3. KATOGORIA E MJEDISIT JETËSOR, PËRFSHIRJA DHEQËLLIMI I PMMJAS, KORNIZA INSTITUCIONALE	7
4. KORNIZA LIGJORE	8
4.1. PROCEDURA NACIONALE E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT MBI MJEDISIN JETËSOR PËR ZHVILLIM TË PROJEKTIT.....	8
4.2. PROCEDURA NACIONALE E VLERËSIMIT TË MJEDISIT JETËSOR PËR PROJEKTE TË PËRMASAVE TË VOGLA.....	8
4.3. KONSULTIME PUBLIKE RRETH PLANIT PËR MENAXHIM ME MJEDISIN JETËSOR PËR PROPJEKTIN.....	10
5. PASQYRA E KRIVA PALLANKËS	11
6. NDIKIMI SOCIAL DHE NDIKIMET MBI TRASHËGIMINË KULTURORE	11
7. NDIKIMET MBI MJEDISIN JETËSOR	13
7.1.1. Emetimet në ajër.....	13
7.1.2. Emetimet në ujë dhe kanalizim	14
7.1.3. Krijimi i mbeturinave	14
7.1.4. Emetimet në tokë.....	15
7.1.5. Zhurma, vibrimet dhe rrezatimi jo jonizues.....	15
7.1.6. Biodiversiteti (flora dhe fauna).....	15
8. Masat për relativizim	16
8.1. Masat për relativizim të ndikimeve negative në ajër.....	16
8.2. Masat për relativizim të ndikimeve negative mbi ujrë.....	16
8.3. Masat për relativizim të ndikimeve negative nga mbeturinat.....	17
8.4. Masat për relativizim të ndikimeve negative mbi tokën.....	17
8.5. Masat për relativizim të ndikimeve negative të shkaktuara nga zhurma, vibrimet dhe rrezatimi jo jonizuese	18
8.6. Masat për relativizim të ndikimeve negative mbi biodiversitetin.....	18
9. Plani për relativizim	19
10. Plani për monitorim	29
ANEKSI 1	36
ANEKSI 2	38

1. HYRJE

Projekti për Konkurrencë Lokale dhe Rajonale (PKLR) është operacion investimi katër vjeçar, i mbështetur nga Bashkimi Evropian duke i shfrytëzuar fondet IPA 2, të dedikuara për konkurrencë dhe inovacion në Maqedoni. PKLR përbëhet nga katër komponenta, i menaxhuar si fond hibrid, që zbatohet përmes Bankës Botërore dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me këtë Projekt do të sigurohen mjetet për të investuar dhe ndërtuar kapacitete për të mbështetur rritjen e sektorit, investime në destinacione dhe të krijim të prosperitetit për destinacione të caktuara. Në nivelin rajonal dhe lokal, projekti do të mbështesë destinacionet e zgjedhura të turizmit në vend përmes kombinimit të ndihmës teknike për përmirësim të menaxhimit me destinacionin, për investime në infrastrukturë dhe investime në ndërlidhje dhe inovacion. Ky dokument i përgatitur si plan për menaxhimi të mjedisit jetësor dhe aspekteve sociale u referohet aktiviteteve të planifikuara në kuadër të projektit "Kriva Pallanka - Porta Lindore kah Evropa (atraksion festivalo - turistik)". Plani i Menaxhimit të Mjedisit Jetësor dhe Aspekteve Sociale është një dokument që përbëhet nga përshkrimi i projektit, detajet teknike, fushëveprimi, mjedisi dhe vendndodhja, në bazë të të cilave vlerësohen rreziqet dhe ndikimet mbi mjedisin jetësor dhe rreziqet sociale dhe masat që ndikojnë në relativizimin e rreziqeve dhe ndikimeve të identifikuar. Zbatimi i masave për relativizim të rreziqeve dhe ndikimeve të përshkruara në plan është i detyrueshëm. Implementimi i këtij nën-projekti ofron mundësi për promovim të projektit në nivel ndërkombëtar. Implementimi i projektit "Kriva Pallanka – Porta Lindore kah Evropa (atraksion festivalo – turistik)" do të kontribuojë në rritjen e atraktivitetit në qytet dhe mundësi që turistët potencial, por edhe dashamirët e manastirit Shën Joakim Osogovski të kënaqen në ofertën turistike të qytetit. Përmirësimi i gjendjes ekzistuese të Sheshit të qytetit do të mundësojë krijimin e një vendi që do të shërbejë për gara kulturore dhe vizitorët të kënaqen në festivalin e folklorit, rokut, etno muzikës dhe teatrit. Përmirësimi i infrastrukturës do të sigurojë hapësirë dhe pajisje më bashkëkohor, numër më të madh të vend parkimeve dhe pajisje të re urbane – kiosqe, ku popullata lokale do të mund t'i shesë prodhimet e veta kreative të dedikuara për turistin global. Në atë lokacion veç më ka filluar riparimi i objekteve hotelierike, që do t'i akomodojnë vizitorët e rinj të qytetit. Me atë, synohet që turistët tranzitor t'i shndërrojmë në vizitorë të përhershëm dhe miq të qytetit.

2. PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT

Pozita specifike e qytetit dhe rrjedha vërshimi rapid i turistëve global në vend, që tranzitojnë nëpër të, në masë të madhe ndikojnë në procesin e tranzicionit dhe transformimit të rasteve shoqërore. Numri i madh i turistëve, që kryesisht udhëtojnë drejt Shkupit ose Ohrit, si atraksione turistike, duke kaluar përmes Kriva Pallankës, më së shpeshti si destinacion të fundit e vizitojnë manastirin lokal Shën Joakim Osogovski, duke mos u futur fare në qytet. Komuna e Kriva Pallankës, duke i analizuar mënyrat për tejkalim të këtij të a.q. qytet "by pass", gjegjësisht të kontribuojë në rritjen e vizitave në qytet, implementon aktivitete për zhvillim të manifestimeve kulturore dhe sportive dhe festivaleve me qëllim të rritjes së atraktivitetit në qytet. Janë zhvilluar më shumë festivale tradicional – folklorik, teatral, rok, etno, etj. që kanë kontribuar në rritjen e menjëhershme të vizitave në qytet në disa vitet e fundit. Në atë drejtim, komuna ka zhvilluar aktivitete të ndryshme ndërkombëtare dhe ka zhvilluar partneritet, gjegjësisht binjakëzim të qyteteve të vendeve të ndryshme të Evropës, përfaqësuesit e të cilëve, me sukses kanë marrë pjesë në këto festivale. Mikpritja e mirë ka çuar në rritjen e vizitave në qytet nga mysafirë të tjerë të këtyre qyteteve, me çka zhvillimi i turizmit vetvetiu u imponua si degë kryesore e së ardhmes në fushën e ekonomisë, kyçe për sigurim të zhvillimit të qëndrueshëm.

Megjithatë, kjo lëvizje e pjeshme në lëmin e kulturës dhe zhvillimi i festivaleve i shfaqën të gjitha mangësitë që i ka qyteti për krijim të zhvillimit të qëndrueshëm të bazuar në këto ngjarje. Infrastruktura e keqe dhe jo funksionaliteti i pjesës qendrore të qytetit, kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e mëtejshëm të këtij lloji specifik të turizmit. Sheshi i qytetit në pjesën qendrore të qytetit është i tipit të vjetër, jo funksional edhe në aspekt të organizimit të ngjarjeve dhe pritjen e mysafirëve edhe në aspekt të arritjes së përfitimt ekonomik nga aktivitetet e caktuar në të. Riparimi i paraparë do ta ndryshojë pasqyrën, gjegjësisht do të krijohet një objekt i ri me përmbajtje shumë më tërheqëse për vizitorët, por edhe do të tërheqë turistë të rinj. Në kuadër të projektit janë paraparë këto aktivitete:

Përshkrimi i punëve:

- Riparimi i skenës ekzistuese në sheshin e qytetit, e cila është e vjetër, jo funksionale, e dëmtuar dhe jo e rrafshët, me çka krijohet ndjenja e jo rehatisë së vizitorëve në aktivitetet e festivaleve. Me këtë projekt është paraparë që të ndërtohet një amfiteatër në vend të binës ekzistuese jo funksionale, që është shkak kryesor për përgatitjen e këtij propozim nën – projekti, si dhe krijimi i hapësirës për vendosje të skenës montuese lëvizëse, e pajisur me ndriçim komplet – teknikë zërimi për nevojat e aktiviteteve të festivaleve. Me këtë, drejtpërsëdrejti do të zvogëlohen harxhimet që i shkaktohen komunës për huazim të shpeshtë të elementeve dhe pajisjeve të tilla.

Hapësira e përgjithshme që do ta përfshijë sheshi me amfiteatrin do të jetë 1660 m², prej të cilave 1200 m² përfshijnë sheshin me amfiteatër, kurse 460 m² përfshijnë pjesa rreth sheshit, e paraparë për skenën.

- Projekti parasheh riparimin dhe rregullimin e vend parkimeve ekzistuese përreth sheshit të qytetit, si dhe rregullimin e trafikut në vende shtesë për parkim (hapësirë momentalisht e pa rregulluar që shfrytëzohet si vend parkimi) prej 3540 m² (50 vend parkime për automjete private, 6 vende për parkim të taksive dhe 1 vendqëndrim autobusi). Kjo është shumë e rëndësishme për t'u siguruar kushte për zgjidhje të problemit të madh me trafikun dhe parkimin. Zgjidhja e ofruar do të mundësojë qasje deri te ky parking nga rr. "Shën Joakim Osogovski". Stacioni i propozuar i autobusëve do të shfrytëzohet kryesisht për nxënësit e vendbanimeve të tjera që e shfrytëzojnë transportin shkollor.

- Riparimi i hapësirës për parkim do të fillojë me punët përgatitore me shënim dhe rrethim të përmbajtjeve të projektuara rishtazi dhe do të vazhdohet me mënjanim të sipërfaqes ekzistuese të asfaltit (2427 m²) me tampon, mënjanim të sipërfaqes anësore dhe sipërfaqeve ekzistuese të betonit (800 m²), mënjanimin e kalldërmës (1158 m²) dhe bllokave të bekatonit (842 m²). Punët riparuese në hapësirën e parkimit do të follojnë duke vënë një shtresë rëre (20-30 cm). Më tutje, punët riparuese do të vazhdojnë me ndërtim të sipërfaqes së re dhe shënimin e sipërfaqes së parkimit, ku më pastaj do të vendoset asfalti me gjerësi prej 70 mm. Me qëllim që të mënjanohen problemet me procesin e riparimit dhe gërryerjeve plotësuese, do të bëhet riparimi i rrjetit ekzistues nëntokësor në shesh. Do të riparohen gypat e kanalizimit atmosferik (Ø350, me gjatësi 492 m), kanalizimi (Ø100, gjatësia 88,29 m), instalimet e furnizimit me ujë të shatërvanëve (1/2"- me gjatësi 5m, 1"- me gjatësi 20 m, 6/4" – me gjatësi 68 m) dhe kyçjeve elektrike, të projektuara rishtazi, të ndriçimit rrugor.

- Riparimi i sipërfaqes ekzistuese të asfaltit, sipërfaqeve të betonit dhe mënjanimi i kalldërmës me trotuar, me sipërfaqe prej rreth 2200 m². Kalldërma e mënjanuar do të selektohet, pjesa e mirë do të shfrytëzohet sërish, kurse pjesa e ngelur do të deponohet në deponi legale. Riparimi i sipërfaqes do të fillojë me punë përgatitore me shënimin dhe rrethimin e lokacionit për riparim në terren dhe do të vazhdojë me mënjanimin e sipërfaqes ekzistuese të asfaltit me tamponin e saj, mënjanimin e sipërfaqeve të betonit, bllokave të bekatonit. Punët riparuese do të vazhdojnë me vendosjen e bllokave të ri të bekatonit (1160 m²) të vendosura në shtresë prej rëre (≤ 20 cm).

- Riparimi i parkut të pa shfrytëzuar ekzistues me sipërfaqe prej 154 m² do të sigurojë një kënd atraktiv në formë të amfiteatrit të vogël për nevojat e rinisë lokale, për ta kaluar kohën e lirë (lexim të poezisë, organizim të ngjarjeve të vogla muzikore, etj.)





Foto 1. Dizajni i fontanave



f. 2 – gjendja e tanishme e rrugës dhe parkingut (sipërfaqe jo e rrafshët dhe e shkatërruar)



f.3 – Gjendja e tanishme e skenës në shesh (e vjetër, e dëmtuar, komplet jo funksionale)

3. KATEGORIA E MJEDISIT JETËSOR, FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI I PMMJAS

Në kuadër të Njoftimit për mendim pozitiv dhe propozim nga ana e Njesisë së konkurrencës lokale dhe rajonale është dhënë raport nga skringu i ndikimit mbi mjedisin jetësor, me të cilin projekti është klasifikuar në kategorinë B+. Kjo, në përputhje me klasifikimin e verifikuar, nënkupton se projekti është klasifikuar me rreziqe relevant të vegjël mbi mjedisin jetësor, që do të duhet të priten gjatë vetë procesit të implementimit të projektit, për çka nevojitet të përgatitet Plan për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet sociale (PMMJAS). Këto ndikime të pritura nuk janë klasifikuar si të konsiderueshëm, që do të jenë të përmasave më të mëdha ose do të kenë efekt më afatgjatë.

PMMJAS është përgatitur për aktivitetet e parapara në kuadër të projektit të Komunës së Kriva Pallankës “Promovimi i turizmit në Komunën e Kriva Pallankës”. PMMJAS përmban përshkrim të projektit, detaje teknike, fushëveprimin dhe lokacionin, në bazë të të cilëve janë vlerësuar edhe rreziqet mbi mjedisin jetësor dhe social. PMMJAS i identifikon masat e qëndrueshme dhe efektive që mund t'i reduktojnë ndikimet potenciale negative mbi mjedisin jetësor dhe social dhe mbi trashëgiminë kulturore. Implementimi i masave për relativizim të rreziqeve dhe çështjeve të identifikuar është obligativ. PMMJAS - në e përbënë edhe një përmbledhje e masave institucionale për relativizim dhe monitorim gatë realizimit të aktiviteteve me qëllim të eliminimit të ndikimeve negative mbi mjedisin jetësor dhe social, ose zvogëlimin e tyre deri në një nivel të pranueshëm. Plani, gjithashtu, përfshinë edhe aktivitetet e nevojshme për implementim të këtyre masave. PMMJAS bënë përshkrimin me detaje teknike për çdo masë relativizimi, duke e përfshirë edhe llojin e ndikimit së bashku me skicat, përshkrimin e pajisjeve dhe procedurave të veprimit, si dhe ndikimet potenciale adekuate, vlerësimet mbi mjedisin jetësor të këtyre masave dhe siguron lidhjen me planet tjera për relativizim, të domosdoshëm për projektin e Komunës së Kriva Pallankës, që është si shtesë, Aneks 2 i këtij PMMJAS.

4. KORNIZA LIGJORE

4.1. PROCEDURA E VLERËSIMIT NACIONAL TË NDIKIMIT MBI MJEDISIN JETËSOR PËR ZHVILLIM TË PROJEKTIT

Procedura e vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor është përshkruar në Ligjin për mjedisin jetësor, Gazeta zyrtare nr. 53/05, 81/05 24/07, 159/08, 83/09, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16 dhe 99/18) (Kreu 11/Neni 76-94) ku kërkesat e direktivave të EIA (Direktiva 85/337/ESS në përputhje me ndryshimet e direktivave 97/11/ES, 2003/35/ES dhe 2009/31/ES) janë transponuar.

Procedura fillon atëherë kur investuesi (kërkuesi i projektit) që synon ta implementojë atë parashtron Letër me dedikim, në formë të shkruar dhe elektronike deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH – Drejtoria e Mjedisit Jetësor), që është organ përgjegjës për tërë procedurën. Drejtoria e Mjedisit Jetësor është e obliguar të japë përgjigje për kërkesën konkrete, se a nevojitet ose jo të zhvillohet SVMJ (Strategjia për vlerësim të mjedisit jetësor), VNMJ (Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor) ose elaborat për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Procedura e skringut është faza kur MMJPH vendos se a duhet të zbatohen SVMJ (Strategjia për vlerësim të mjedisit jetësor), VNMJ (Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor) ose elaborat. Për zhvillim të projekteve që nuk bëjnë pjesë në listën e projekteve për të cilët duhet patjetër të zbatohet procedura VNMJ (Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor) (**projekte të përmasave më të vogla**), duhet të përgatitet elaborat për mbrojtje të mjedisit jetësor (Raport për ndikim mbi mjedisin jetësor) (**projekte relevant të kategorisë B nën SB OP 4.0.1 procedura për vlerësim të mjedisit jetësor**).

4.2. PROCEDURA NACIONALE PËR VLERËSIM TË MJEDISIT JETËSOR PËR PROJEKTE TË PËRMASAVE MË TË VOGLA

Gjatë procedurës nacionale VNMJ (Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor) përgjatë kohës së skringut, nëse nga ana e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor nxirret Vendim se nuk nevojitet zbatimi i procedurës VNMJ (Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor), investuesi duhet të fillojë procedurë për zhvillim të **Elaboratit** për mbrojtje të mjedisit jetësor. Kjo procedurë është obligative për projekte të përmasave më të vogla që shkaktojnë ndikime të vogla, afatshkurta negative mbi mjedisin jetësor kur Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në kuadër të vendimit të lartë përmendur ka deklaruar se nevoja për përgatitje të Elaboratit është në përputhje me rregulloret që janë përmendur më poshtë (si p.sh.: Riparimi apo konstruksioni i rrugëve lokale, udhëve, konstruksioni i rrjeteve lokal të ujësjellësit, kanalizimeve dhe IPUZ – Instalim për pastrim të ujërave të zeza) me përmasa të vogla – më pak se 10 000, etj.).

Ekzistojnë dy Urdhëresa që kanë të bëjnë me projektet për të cilët duhet të përgatitet Elaborat për mbrojtje të mjedisit jetësor:

A) Urdhëresa për ndryshim të urdhëresës për veprimtaritë dhe aktivitetet për të cilët detyrimisht përgatitet elaborat, kurse për miratimin e të cilit kompetent është organi për kryerje të punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor (Gazeta zyrtare e RM nr. 36/12);

B) Urdhëresa për ndryshim të urdhëresës për veprimtaritë dhe aktivitetet për të cilët detyrimisht përgatitet elaborat, e për miratimin e të cilëve është kompetent kryetari i komunës, kryetari i qytetit të Shkupit dhe kryetari i komunave në qytetin e Shkupit (Gazeta zyrtare e RM nr. 32/12);

Elaborati i përmban karakteristikat kryesore të aktiviteteve projektuese, ndikimet kryesore pozitive dhe negative mbi mjedisin jetësor, që janë hasur gjatë shqyrtimit të të dhënave themelore të mjedisit jetësor, që janë specifike për lokacionin konkret. Programi tejet më i thjeshtë për mbrojtje të mjedisit jetësor përbëhet nga masa të llojllojshme që do ta pengojnë, relativizojnë dhe kompensojnë ndikimin negativ mbi të gjithë elementet të mjedisit jetësor, në bazë të legjislaturës nacionale të mjedisit jetësor dhe praktikës pozitive ndërkombëtare. Nuk parashihet debat publik për përgatitje dhe pranim të Elaboratit për mbrojtje të mjedisit jetësor, në Foton 4 është dhënë skema më e thjeshtë e procedurës për Elaborat për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe organizmi kompetent për pranim të Elaboratit për mbrojtje të mjedisit jetësor.



F. 5. VNMJ (Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor) procedura për projekte të pëmasave më të vogla (Elaborati për mbrojtje të mjedisit jetësor)

Procedura e vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor bëhet në përputhje me Ligjin për mjedisin jetësor, (Gazeta zyrtare nr. 53/05, 81/05 24/07, 159/08, 83/09, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16 dhe 99/18) (Kreu 11/Neni 76-94) ku kërkesat e direktivave të EIA (Direktiva 85/337/ESS në përputhje me ndryshimet e direktivave 97/11/ES, 2003/35/ES dhe

2009/31/ES). Procedura fillon atëherë kur investuesi (Propozues i projektit) që synon ta implementojë projektin parashtron Letër me dedikim, në formë të shkruar dhe elektronike deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH – Sektori i mjedisit jetësor), jep përgjigje për procedurën në përgjithësi, që është e obliguar të japë mendim në lidhje me lëndën dhe se a nevojitet ose jo përgatitja e Elaboratit për mjedisin jetësor.

Procedura e kontrollit është faza në të cilën MMJPH vendos se a nevojitet ose jo Elaborati se Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor.

Lidhur me njoftimin e dërguar për qëllimin për të realizuar një projekt që Komuna e Kriva Pallankës ia ka dërguar Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, është sugjeruar që për këtë projekt nuk duhet të përgatitet Elaborat për mbrojtjen e mjedisit jetësor (në Aneksin 2 të këtij plani është përfshirë mendimi).

4.3. KONSULTIMET PUBLIKE RRETH PLANIT PËR MENAXHIM ME MJEDISIN JETËSOR PËR PROJEKTIN

Plani i përgatitur për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet sociale (PMMJAS) për këtë projekt do të jetë pjesë e dokumentacionit të tenderimit dhe kontratës me realizatorin (së bashku me llogari matjet) që do të jenë obligative për implementim të masave të parapara në përputhje me Planin për relativizim dhe monitorim. Implementimi i PMMJAS është obligativ për realizatorin.

Inxhinieri mbikëqyrës, i angazhuar nga komuna, ka për obligim ta mbikëqyr dhe vlerësojë implementimin e masave të propozuara në kuadër të planit për monitorim dhe ta njoftojë investitorin dhe zyrën e projektit PKLR (Projekti për konkurrencë lokale dhe rajonale)/Komuna e Kriva Pallankës. Komuna do të njoftojë për gjendjen e mjedisit jetësor dhe zbatimin e masave për relativizim dhe monitorim në raportet e rregullt për avancim të nën – projektit dhe në Raportin e posaçëm për implementim të PMMJ, çdo tre muaj (nëse nuk është përcaktuar ndryshe nga ana e personit profesional për mjedisin jetësor, të lejuar nga eksperti i mjedisit jetësor dhe SB) deri te eksperti i mjedisit jetësor.

Në përputhje me KMMJ – (Korniza për menaxhim me mjedisin jetësor), për këtë PMMJAS patjetër duhet të realizohet konsulencë publike para se nën – projekti të miratohet përfundimisht. Pasi që draft versioni i PMMJ do të miratohet nga eksperti i mjedisit jetësor të Njësisë për implementim të projektit (NJIP) dhe eksperti i mjedisit jetësor nga SB, i njëjti do të publikohet në faqen elektronike (NJIP) / Kabineti i zëvendës Kryetarit të Qeverisë së RM për çështje ekonomike, Agjencia për Promovim dhe Përkrahje të Turizmit, faqja elektronike e komunës së interesuar (Komuna e Kriva Pallankës) ku do të jetë i qasshëm për opinionin 14 ditë. Një kopje e printuar do të dërgohet te Njësia për implementim të projektit (NJIP)/Kabineti i zëvendës Kryetarit të Qeverisë së RM për çështje ekonomike (KZKÇE) dhe Komuna e Kriva Pallankës. Thirrja për komentim dhe pjesëmarrje në takim për konsulencë publike (me vend dhe kohë) do të shkojë së bashku me PMMJAS. Takimi i konsulencës publike do të mbahet në komunën e interesuar kah fundi i periudhës për konsultime. Aplikuesi (Komuna e Kriva Pallankës), në mënyrë pro aktive do t'i informojë dhe ftojë aktorët e mëdhenj në projekt, duke i përfshirë edhe OJQ – të, komunitetet e interesuar dhe komunat në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe adekuate. Komentet e parashtruar do të përfshihen në Procesverbal për dëgjim publik, që do të jetë pjesë e versionit final të PMMJAS. Në atë mënyrë, të gjithë komentet e opinionit do të jenë të qasshëm për aplikantët dhe ata do t'i marrin të gjithë komentet relevante dhe do t'i përfshijnë përgjigjet dhe vërejtjet në PMMJAS final.

PMMJAS patjetër duhet të kalojë në konsulencë publike në anglisht, maqedonisht dhe shqip implementimi i Panit për menaxhim të mjedisit jetësor dhe aspekte sociale do të mundësojë ndërmarrjen me kohë të masave të propozuara dhe do të kontribuojë në realizimin e aktiviteteve projektuese pa ndikime të konsiderueshme mbi mjedisin jetësor.

Në Aneksin 2 të këtij PMMJAS është edhe Mendimi i Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të RM.

5. PASQYRA E KOMUNËS SË KRIVA PALLANKËS

Aktivitetet e ndërlidhur me implementimin e projektit “Kriva Pallanka – Porta Lindore kah Evropa (Atraksion festivalo – turistik) do të zhvillohen në territorin e Kriva Pallankës.

Komuna e Kriva Pallankës është Njësi e vetëqeverisjes lokale që e kryen punën e saj në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Komuna është qendër servitore e qytetarëve në sferën e problemeve komunale, ndërtimit, planifikimit urban, tatimit, arsimit, mbrojtjes së mjedisit jetësor, kulturës, sportit, etj.

Përmes administratës komunale dhe përmes Ndërmarrjes Publike Komunale “Komunalec” themelues i së cilës është Komuna e Kriva Pallankës, komuna përpiqet t'i përmbushë nevojat e banorëve të komunës. Detyrat kryesore të Ndërmarrjes komunale janë mirëmbajtja e ujësjellësit, kanalizimit në komunë, menaxhim me mbeturinat, mirëmbajtja e higjienës komunale, mirëmbajtja e tregjeve lokale, sipërfaqeve të gjelbra dhe parqeve, si dhe mirëmbajtje e kanaleve të kanalizimit dhe sistemit kolektorial.

Komuna e Kriva Pallankës ka kapacitet të menaxhojë me mjedisin jetësor në territorin e saj përmes Sektorit për planifikim urbanistik, trafik, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe infrastrukturës komunale, si dhe përmes inspektorit të autorizuar për mjedis jetësor. Komuna e Kriva Pallankës është njësi e vetëqeverisjes lokale me seli në qytetin e Kriva Pallankës.

Pushtete lokale janë kryetari i komunës, që është personi përgjegjës, e përfaqëson komunën dhe Këshilli i Komunës, që përbëhet prej 19 këshilltarëve si organ që i përfaqëson banorët e komunës. Në drejtim të implementimit të aktiviteteve që janë në kompetencë të komunës, administrata komunale përbëhet prej 72 punonjësve në përputhje me Ligjin për sistematizim, e organizuar në dy sektorë dhe nëntë njësi:

- Sektori për çështje juridike, çështje financiare dhe zhvillim ekonomik lokal, që përbëhet prej:
 - Njësisë për çështje juridike dhe të përgjithshme
 - Njësisë për çështje financiare
 - Njësisë për veprimtari publike, zhvillim ekonomik dhe teknologji informatike
- Sektori i urbanizmit, trafikut, mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe infrastrukturës komunale që përbëhet prej:
 - Njësisë së urbanizmit, trafikut dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor
 - Njësisë për ndërtim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës komunale
- Njësia për mbikëqyrje inspektuese
- Njësia për resurse njerëzore
- Njësia për revizion të brendshëm
- Njësi Territorial Kundër Zjarrit Komunës së Kriva Pallankës

Kriva Pallanka është qytet në pjesën Verilindore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qyteti i Kriva Pallankës është seli e Komunës së Kriva Pallankës..

Komuna e Kriva Pallankës ka 34 vendbanime.

sipas regjistrimit të popullsisë, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë, viti 2002:

Gjithsej popullsi: 20820

Amvisëri: 6600

Popullsia sipas nacionalitetit:

Maqedonas: 19998

Turq: 2

Romë: 668

Vlleh: 3

Serbë: 103

Boshnjakë: 2

Të tjerë: 44

6. NDIKIMI SOCIAL DHE NDIKIMI MBI TRASHËGIMINË KULTURORE

Nën projekti i propozuar parasheh përmirësimin e infrastrukturës në pjesën qendrore të qytetit, me qëllim të përmirësimit të kushteve zhvillimore të turizmit në qytet, gjegjësisht pranimin e turistëve dhe mundësimin e kushteve për vazhdim të qëndrimit të tyre me rritjen e pjesëmarrjes së tyre në ekonominë lokale. Qëllimi është që të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm i ekonomisë lokale dhe përmirësimi i kualitetit të jetesës së popullatës lokale. Krijimi i amfiteatrit funksional në vend të atij të skenës së vjetër jo funksionale do të kontribuojë për përmirësimin e kualitetit të festivaleve dhe manifestimeve të tjera, gjegjësisht tërheqjen e turistëve të rinj. Vendosja e kiosqeve dhe pajisjeve urbane do të krijojë kushte dhe mundësi për vepruesit lokal dhe kreatorët që t'ua sheshin prodhimet e tyre turistëve dhe do të krijojë mundësi që turistët ta ndjejnë autenticitetin e kuzhinës lokale tradicionale. Vetë paralajmërimi i përgatitjes së nën projektit veç më e motivon riparimin e hotelit ekzistues në shesh, me qëllim që të akomodojë numër sa më të madh të vizitorëve dhe t'i përmbushë kërkesat e turistëve të sotëm. Realizimi i nën projektit do të nxisë edhe ndërtimin e hoteleve të rinj dhe kapaciteteve akomoduuese. Lidhja e shëtitorës dhe shtegut të biçikletave përmes amfiteatrit të vogël, në mënyrë shtesë do ta rrisë atraktivitetin e objektit dhe do të mundësojë ndërtimin e përmbajtjeve objekteve shtesë për rekreacion dhe shitje të produkteve dhe ofrim të shërbimeve në KEJ. Implementimi i nën projektit do të mundësojë edhe formimin e tërësisë komplete funksionale me park model lulesh, hapësira parkimi dhe hapësira për mbajtje të ngjarjeve, i gatshëm të pranojë më shumë mysafirë dhe i pajisur me kiosqe dhe tezgja, ku prodhuesit lokal do të mund t'i shesin produktet e tyre që do të bëhen plotësisht të qasshëm për turistët. Implementimi i nën projektit në aspekt social është absolutisht relevant dhe pozitiv.

Në këtë lokacion nuk ka objekte (ndërtesa, përmendore, objekte të tjera) që kategorizohen si monumente kulturore – historike, dhe për këtë implementim i nën – projektit të propozuar nuk parasheh dhe nuk ka kurrfarë ndikimi mbi trashëgiminë kulturore. Kalldërma e mënjanuar do të selektohet, kockat e mira do të shfrytëzohen sërish, kurse të tjerat do të hidhen në deponi.

7. NDIKIMET MBI MJEDISIN JETËSOR

Ndikimet kryesore mbi mjedisin jetësor identifikohen dhe sqarohen në detaje në këtë nën kapitull.

Në aspekt të prodhimit të mbeturinave të forta, duke e marrë parasysh natyrën e punëve ndërtimore, pritet prodhimi i mbeturinave inerte (dhe, gurë dhe asfalt/beton) edhe atë në fazë të riparimit të infrastrukturës ekzistuese në qendër të qytetit, posaçërisht gjatë ndërtimit të amfiteatrit. Ndikim më të vogël pritet edhe në fazën e prokurimit dhe vendosjes së pajisjeve mobile urbane, kiosqeve dhe tezgave, si dhe gjatë montimit dhe vendosjes së skenës lëvizëse për performancat muzikore dhe festivalet. Gjithashtu, një sasi e caktuar e mbeturinave të forta

(komunale) pritet të prodhohet nga vetë punëtorët e ndërtimit, të angazhuar gjatë procesit të ndërtimit. Ndikimi është klasifikuar si i ulët.

Në raport me ndotjen e ajrit pritet të shkaktohet pluhur gjatë procesit të riparimit të infrastrukturës ekzistuese nga zhvendosja ose mënjanimi i dheut, gurëve, betonit, asfaltit, posaçërisht gjatë transportit të materialit ndërtimor dhe mënjanimit të bërllokut dhe materialit të pa përdorshëm. Në përputhje me punët e planifikuara ndërtimore, emetimet që priten janë të përkohshëm dhe të limituar gjatë periudhës së ndërtimit.

Në raport me ndotjen e tokës dhe ujit, vetë procesi kërkon angazhim të pajisjeve dhe mekanizimit të rëndë, që e rritë mundësinë e erërave të pa këndshme gjatë hedhjes së vajit, karburanteve le lubrifikantëve të tjerë. Mundësia është minimale dhe e njëjta mund të reduktohet me zbatim të një prakse të mirë ndërtimore.

Në aspekt të zhurmës pritet emision i shkaktuar nga transporti i pajisjeve, materialeve dhe aktiviteteve të parapara ndërtimore për mënjanim të binës ekzistuese dhe realizim të amfiteatrit, vendosjen e kiosqeve dhe rregullimit të lokacionit rreth amfiteatrit. Ndikimi është minimal dhe emetimet e zhurmës janë të përkohshëm.

7.1. Emetimet e ajrit

Gjatë realizimit të projektit për rindërtimin e sheshit të qytetit, emetimet e ajrit priten gjatë fazës së ndërtimit dhe në fazën operative të sheshit të qytetit.

Emetimet e pluhurit dhe shkarkimit priten gjatë fazës së ndërtimit.

Në fazën operacionale, emetimet e ajrit kryesisht priten nga përdorimi i rrugës së qytetit që kalon drejtpërdrejt në sheshin e qytetit, të shprehur përmes emetimeve të shkarkimeve, por edhe emetimeve të pluhurit nëse lokacioni i rregulluar nuk mirëmbahet si duhet.

● Emetimet e pluhurit

Burimet e emetimit të pluhurit gjatë ndërtimit kanë të bëjnë me aktivitetet për pastrimin e tokës, kryerjen e gërmimeve të planifikuara, përgatitjen e punimeve të betonit, punimet e murimit, rregullimin e dyshemesë.

Emetimet e pluhurit do të varen nga kryerja e aktiviteteve, masat e aplikuara dhe kohëzgjatja e aktiviteteve të ndërtimit.

● Emetimet e gazrave frymor

Gazrat e shkarkimit në ajër do të lëshohen nga makineritë e ndërtimit dhe automjetet e transportit që shërbejnë për të kryer punë ndërtimore. Emetimi i gazrave të shkarkimit do të varet nga përbërja e karburantit që do të përdoret, frekuenca e lëvizjes së makinerive dhe automjeteve dhe kohëzgjatja e aktiviteteve të ndërtimit.

7.2. Emetimet e ujit dhe kanalizimit

Gjatë rindërtimit të sheshit të qytetit, ndotja e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë mund të ndodhë në rast të rrjedhjes së karburantit, vajit motorik, lubrifikantëve dhe substancave të tjera të rrezikshme nga automjetet që do të kryejnë veprimtari ndërtimi. Trajtimi i duhur i këtyre substancave të rrezikshme do të eliminojë ndotjen e mundshme.

Uji atmosferik i mbledhur në vendin në fjalë do të mbulohet nga sistemi ekzistues i kanalizimit atmosferik.

7.3. Krijimi i mbeturinave

Në fazën e ndërtimit shumica e mbeturinave të gjeneruara do të jenë mbeturina inerte të krijuara gjatë punimeve përgatitore dhe tokësore. Mbetjet inerte të gjeneruara hyjnë në kategorinë e mbeturinave jo të rrezikshme. Nuk ndikon negativisht në mjedis, por është e nevojshme të gjendet një vendndodhje e përshtatshme ku do të hidhet.

Në fazën e ndërtimit gjithashtu do të gjenerohen mbeturinat komunale dhe mbeturinat e paketimit.

Tabela e mëposhtme tregon llojet e mbeturinave që do të gjenerohen gjatë aktiviteteve të ndërtimit.

Tabela: Llojet e mbeturinave

Numri rendor	Lloji i mbeturinave	Numri i Listës së llojeve të mbeturinave (Gaz. Zyrtare e RM nr. 100/05)	Mënyra e procedimit me mbeturinat (përpunimi, deponimi, dorëzimi, mënjanimi etj.)	Emri i personit juridik që procedon me mbeturinat dhe lokacionin ku mënjanohen mbeturinat (deponia)
1	Mbeturina të përziera komunale	20 03 01	Të deponuar në lokacion të posaçëm dhe të shënuar (kontejnerë) në lokacion para mënjanimit të tyre nga kompania e licencuar	NP "Komunalec" Kriva Pallnkë dhe procedues të tjerë të licencuar
2	Paketimi i letrës dhe kartonëve	15 01 01	Të deponuar në lokacion të posaçëm dhe të shënuar (kontejnerë) në lokacion para mënjanimit të tyre nga kompania e licencuar	NP "Komunalec" Kriva Pallnkë dhe procedues të tjerë të licencuar
3	Paketime të plastikës	15 01 02	Të deponuar në lokacion të posaçëm dhe të shënuar (kontejnerë) në lokacion para mënjanimit të tyre nga kompania e licencuar	NP "Komunalec" Kriva Pallnkë dhe procedues të tjerë të licencuar
4	Dhe dhe gurë të përmendur në 17 05 03	17 05 04	Të deponuar në lokacion të posaçëm dhe të shënuar (kontejnerë) në lokacion para mënjanimit të tyre nga kompania e licencuar	NP "Komunalec" Kriva Pallnkë dhe procedues të tjerë të licencuar
5	Mbetje dhe fraksione tjera të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikave ndryshe nga ato në 17 01 06	17 01 07	Të deponuar në lokacion të posaçëm dhe të shënuar (kontejnerë) në lokacion para mënjanimit të tyre nga kompania e licencuar	NP "Komunalec" Kriva Pallnkë dhe procedues të tjerë të licencuar
6	Mbetje bituminoze të pa përmendura në	17 03 02	Të deponuar në lokacion të posaçëm dhe të	NP "Komunalec" Kriva Pallnkë dhe

	17 03 01		shënuar (kontejnerë) në lokacion para mënjanimit të tyre nga kompania e licencuar	procedues të tjerë të licencuar
7	Mbeturina nga vegjetacioni i mënjanuar (mbeturina bio ndërtimore)	20 02 01	Të deponuar në lokacion të posaçëm dhe të shënuar (kontejnerë) në lokacion para mënjanimit të tyre nga kompania e licencuar	NP “Komunalec” Kriva Pallnkë dhe procedues të tjerë të licencuar
8	Sasi të vogla të mbeturinave të rrezikshme		Të deponuar në lokacion të posaçëm dhe të shënuar (kontejnerë) në lokacion para mënjanimit të tyre nga kompania e licencuar	Kompani e licencuar për menaxhim dhe mënjanim të mbeturinave të rrezikshme

Sasia e mbeturinave të krijuara do të mësohet pas përfundimit të punëve ndërtimore.

7.1.4. Emetime në tokë

Realizimi i aktiviteteve të planifikuara të ndërtimit mund të çojë në burime të mundshme të emetimeve që mund të ndikojnë në tokë. Burimet e emetimeve që mund të dëmtojnë cilësinë e tokës janë ujërat e zeza, mbeturinat, rrjedhjet e padëshiruara të karburantit, vaji i motorit, lubrifikantët dhe substancat e tjera të rrezikshme nga automjetet që do të kryejnë aktivitete ndërtimi, emetimet në ajër si sediment, etj. Ndotja e tokës mund të jetë drejtpërdrejt ose indirekt, me anë të transportimit të materieve ndotëse përmes ujërave të ndotur. Masat nuk pritet të ndikojnë negativisht në tokë.

7.1.5. Zhurma, vibracionet dhe rrezatimet jo jonizuese

Gjatë aktiviteteve të ndërtimit pritet një ngritje e nivelit të zhurmës për shkak të përdorimit të makinerive ndërtimore që do të përfshihen në aktivitetet e ndërtimit. Intensiteti i zhurmës së gjeneruar do të varet nga lloji i automjeteve dhe pajisjet e përdorura.

Gjatë fazës operationale pritet të rritet niveli i zhurmës i shkaktuar nga automjetet që përdorin rrugën e qytetit, si dhe gjatë mbajtjes së manifestimeve publike.

7.1.6. Biodiversiteti (flora dhe fauna)

Në fazën e ndërtimit dhe në fazën operative nuk priten ndikime të cilat mund të sjellin efekte të dëmshme në biodiversitet pasi ky vend është në zonën e qytetit dhe nuk është i vendosur në një zonë të mbrojtur.

8. Masat për relativizim

8.1. Masat për relativizim të ndikimeve negative në ajër

Faza e ndërtimit

Gjatë realizimit të aktiviteteve ndërtimore nevojitet të zbatohen masa për zvogëlim të ndikimeve negative në ajër, edhe atë:

- Mirëmbajtja e automjeteve dhe mbulimi i veturave që bartin materiale ndërtimore;
- Mbulimi i automjeteve që i mënjanojnë mbeturinat nga lokacioni;
- Kufizimi i trafikut të pa nevojshëm në lokacionet ku bëhen punë ndërtimore;
- Shfrytëzimi i karburantit kualitativ për automjetet;
- Shfrytëzimi i pajisjeve që nuk emetojnë gazra lëshues;

Minimizimi i krijimit të pluhurit gjatë periudhave të thatësirës me ujitje të lokacionit dhe materialit inert të deponuar përkohësisht.

Faza operative

Gjatë fazës operative nevojitet të bëhet pastrimi i rregullt dhe fshirja e lokacionit në mënyrë që të penohet krijimi i pluhurit.

8.2. Masat për relativizim të ndikimeve negative mbi ujërat

Faza e ndërtimit

Gjatë realizimit të aktiviteteve ndërtimore nevojitet të zbatohen masa për zvogëlim të ndikimeve negative mbi ujërat, edhe atë:

- mirëmbajtja e rregullt e ujërave dhe mekanizmit ndërtimor me qëllim që t'i iket rrjedhjes së karburanteve, vajit motorik dhe substancave të tjera të rrezikshme;
- mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve të bëhet nga një servis i autorizuar;
- prolongimi i përkohshëm i materialit ndërtimor dhe mbeturinave të sigurohet në mënyrë që nuk do të mund të shkaktohen rrjedhje të pa dëshirueshme;

Faza operative

Gjatë fazës operative nuk priten ndikime negative mbi ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor.

8.3. Masat për relativizim të ndikimeve negative nga mbeturinat

Faza e ndërtimit

Gjatë realizimit të aktiviteteve ndërtimore nevojitet të zbatohen masa për zvogëlim të ndikimeve negative nga mbeturinat, edhe atë:

- Sigurimi i kontratave me procedues të autorizuar me mbeturinat;
- Mbeturinat e krijuara që përkohësisht janë vendosur në lokacion ndërtimor duhet të jenë larg njëri – tjetrit dhe të shënohen (i rrezikshëm/jo i rrezikshëm/inert) deri në momentin e heqjes;

- Në lokacion ndërtimor nuk do të ngelin mbeturina pas përfundimit të aktiviteteve ndërtimore;
- Ndalohet djegia e mbeturinave;
- Nëse është e mundur një pjesë e mbeturinave inerte të shfrytëzohet sërish si material ndërtimor me çka do të realizoheshte parimi i menaxhimit integrues me mbeturinat;
- Mbeturinat e dëmshme që eventualisht mund të krijohen, të mblidhen në enë të posaçme të shënuara dhe të njëjtat të mënjahohen na proceduesi eventual me mbeturina të llojit të tillë;
- Mbeturinat inerte të mënjahohen në deponi për mbeturina inerte;
- Mbeturinat e krijuara komunale të mënjahohen na NP “Komunalec” Kriva Pallankë dhe të njëjtat të transportohen në deponinë e mbeturinave komunale të qytetit;
- Menaxhimi me mbeturinat do të bëhet në përputhje me legjislaturën nacionale.

Faza operative

Gjatë fazës operative lokacioni do të pajiset me enë për mbeturina që do të jepen na NP “Komunalec” Kriva Pallankë.

8.4. Masat për relativizim të ndikimeve negative mbi tokën

Faza e ndërtimit

Gjatë realizimit të aktiviteteve ndërtimore duhet të zbatohen masa për zvogëlim të ndikimeve negative mbi tokën, edhe atë:

- Planifikimi i vëmendshëm i punëve ndërtimore me qëllim të zvogëlimit të efekteve negative të mundësojë pengimin e ndotjes së tokës;
- Mekanizmi ndërtimor dhe automjetet do të servisojnë me rregull në mënyrë që t'i iket rrjedhjes së karburantit, vajit motorik, lubrifikantëve dhe substancave të tjera të rrezikshme;
- Menaxhimi i vëmendshëm i mbeturinave në përputhje me legjislaturën nacionale;
- Nëse gjatë realizimit të punëve ndërtimore nevojiten karburante, vajra motorik, lubrifikantë, etj., ato të ruhen në enë adekuate, në sasi të vogla, të mbrojtur nga çdo ndikim i jashtëm;
- Sigurimi i materialit ndërtimor dhe mbeturinave në kushte të shiut në mënyrë që të pengohet ndotja eventuale e tokës dhe ujërave sipërfaqësor dhe atmosferik.

Faza operative

Në fazën operative duhet të menaxhohet me mbeturinat në përputhje me legjislaturën nacionale.

8.5. Masat për relativizim të ndikimeve negative të shkaktuar na zhurma, vibrimet dhe rrezatimi jo jonizues

Faza e ndërtimit

Gjatë realizimit të punëve ndërtimore duhet të zbatohen masa për zvogëlim të ndikimeve negative nga zhurma, edhe atë:

- informacione publike (të qasshëm për banorët lokal) para fillimit të aktiviteteve ndërtimore;
- aktivitetet ndërtimore do të realizohen vetëm gjatë ditës;
- shfrytëzimi i pajisjeve që do të krijojnë nivel të ulët të zhurmës;
- mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve;
- aktivitetet ndërtimore do të planifikohen ashtu që të shkurtohet koha e shfrytëzimit të pajisjeve që shkaktojnë zhurmë;
- Përdorimi i praksave më të mira ndërtimore me theksim të veçantë të niveleve të zhurmës.

Ndikimi i vibracioneve pritet të jetë jo i konsiderueshëm dhe vetëm në lokacionin e ndërtimit.

Faza operative

Gjatë fazës operative nevojitet:

- gjatë mbajtjes së ngjarjeve kulturore dhe publike të ruhen vlerat kufizuese të zhurmës në përputhje me rregullativën nacionale ligjore;
- kufizimi i nivelit të zhurmës së pajisjeve të zërimit gjatë kohës së mbajtjes së ngjarjeve publike;
- kontrolli i trafikut në rrugët e qytetit;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës dhe pajisjeve urbane dhe kontrollet e rregullta të sigurisë.

8.6. Masat për relativizim të ndikimeve negative mbi biodiversitetin

Faza e ndërtimit

Nuk do të mënjanohet sipërfaqja e gjelbër. Drunjtë ekzistues nuk do të dëmtohen ose mënjanohen gjatë punëve. Në fazën e ndërtimit nuk priten ndikime negative mbi llojlojshmërinë biologjike. Rregullimi do të bëhet vetëm me florë natyrore.

Faza operative

Gjatë fazës operative nuk priten ndikime negative mbi biodiversitetin.

9. Plani i relativizimit

Plani i Menaxhimit të Mjedisit Jetësor dhe Menaxhimit Social PMMJMS është një dokument që përcakton masat, procedurat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në zbatimin e projektit. PMMJMS përbëhet nga një grup masash lehtësuëse, monitoruese dhe institucionale që duhen ndërmarrë gjatë zbatimit, si dhe operacione për të eliminuar ndikimet e pafavorshme mjedisore dhe sociale, për t'i korrigjuar ose zvogëluar deri në një nivel të pranueshëm.

Aktivitetet kryesore obligative për relativizim janë përshkrua në Tabelën 2.

Plani i zvogëlimit të ndikimit në mjedis gjatë fazës së rindërtimit dhe operacionit përshkruan masat zbutëse, kostot dhe përgjegjësitë në zbatimin e tyre. Plani gjen mënyra më të mira për të ndërmarrë veprime për të zvogëluar ose eliminuar ndikimet negative.

Raporti i zbatimit të PMMJAS do të jetë tremujor. Për të siguruar një shkallë të caktuar të ndikimit mjedisor tek Kontraktuesi, një klauzolë e përshtatshme do të futet në kontratat e punimeve, duke përcaktuar gjokat për mosrespektimin e dispozitave të kontraktimit mjedisor, p.sh. në formën e mbajtjes në pritje të disa prej pagesave derisa masat korrigjuëse dhe nën-projekti të zbatohen në përputhje me madhësinë e tij në varësi të ashpërsisë së shkeljes së kontratës. Në raste ekstreme, kontraktimi është i lidhur me kontratën.

